



RREGULLORE E LOJËS SË FATIT PROMOCIONALE “PROMO E FUNDVITIT 2024”

Sipas kërkesave të Ligjit nr. 155/2015 “Për Lojrat e Fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 196/2017 “Për Përcaktimin e Mënyrave, Formave, Kritereve dhe Rregullave për Organizimin e Lojërave të Fatit Promocionale”

Neni 1 ORGANIZATORI I LOJËS PROMOCIONALE

- 1.1 Organizatori i Lojës Promocionale “Promo e Fundvitit 2024” është: **Shoqëria “Vodafone Albania” SH.A** (referuar këtu më poshtë si “**Vodafone**”), person juridik shqiptar, themeluar dhe rregulluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT K11715005L, me seli në Autostradën Tiranë-Durrës, Rr. "Pavarësia", Nr.61, Kashar, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar ligjërisht nga Administratori Z.Balazs Revesz. Vodafone është i regjistruar si subjekt tatimpagues në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë.
- 1.2 Me anë të kësaj Loje Promocionale, Vodafone ka për qëllim të promovojë produktet e saj me parapagesë, hibrid (më tej referuar si “**NEXT**”), me paspagesë, fiks dhe Unlimited të disponueshme për Pajtimtarët që përdorin shërbimet e komunikimeve elektronike (më tej referuar si “**Pajtimtarët**”).

Neni 2 AFATI

- 2.1 Loja Promocionale do të zhvillohet në një periudhë kohore prej 24 (njëzet e katër) ditësh kalendarike. Loja promocionale do të fillojë në datë 25.11.2024 dhe do të përfundojë në datën 18.12.2024 në orën 23:59.
- 2.2 Në datë 24.12.2024 do të hidhet shorteu për përzgjedhjen e fituesëve të lojës.

Neni 3 MEKANIZMI I LOJËS PROMOCIONALE

- 3.1 Vodafone ka në treg një seri produktesh me parapagesë, NEXT, me paspagesë, internet fiks dhe Unlimited të disponueshme për të gjithë Pajtimtarët Vodafone. Të gjithë Pajtimtarët e telefonisë së lëvizshme (referuar në vijim si Pajtimtarë mobile) dhe Pajtimtarët e shërbimeve të komunikimeve elektronike të qëndrueshme (referuar në vijim si Pajtimtarë fiks) Vodafone, kanë mundësi të shkarkojnë në aparatin e tyre smartphone aplikacionet MyVodafone dhe JUTH app. Duke hyrë cdo ditë në njërin prej këtyre aplikacioneve, për 24 ditë rresht, këta pajtimtarë do të përfitojnë krahas një produkti që ofrohet falas si: Minuta, SMS, MB, Vcoins ose Kupona Vodafone More (“**dhurata ditore**”) gjithashtu edhe bileta për të marrë pjesë në Lojën e Fatit Promocionale “Promo e fundvitit 2024”.
- 3.2 Pajtimtarët mobile me parapagesë që dëshirojnë të përfitojnë bileta për të marrë pjesë në këtë Lojë Promocionale duhet të hyjnë në aplikacionin MyVodafone ose JUTH app.



- 3.3 Pajtimtarët mobile NEXT me paspagesë dhe Unlimited që dëshirojnë të përfitojnë bileta për të marrë pjesë në këtë Lojë Promocionale duhet vetëm të hyjnë në aplikacionin MyVodafone ose JUTH app.
- 3.4 Pajtimtarët fiks Vodafone që dëshirojnë të përfitojnë bileta për të marrë pjesë në këtë Lojë Promocionale duhet të hyjnë në aplikacionin MyVodafone ose JUTH app dhe të përfitojnë bileta.
- 3.5 Biletat mund të përfitohen vetëm 1 (një) herë gjatë 1 (një) dite, vetëm nga aplikacioni që akeshohet i pari gjatë ditës. Nuk mund të përfitohen bileta nga të dyja aplikacionet brenda 1 (një) dite.
- 3.6 Gjithashtu pajtimtarët në aplikacionin MyVodafone ose JUTH app do të kenë mundësi të përfitojnë 5 bileta shtesë me shpenzimin e 50 Vcoins, 5 herë në ditë.
- 3.7 Në momentin që mbyllet Loja Promocionale, automatikisht do të gjenerohet lista e të gjithë numrave celularë pjesëmarrës në shorte. Numri i pjesëmarrjes për 1 pajtimtar do të replikohet në këtë listë në varësi të numrit të biletave të përfituara gjatë gjithë periudhës 24 ditore sipas nenit 4.1 më poshtë.
- 3.8 Lista e numrave celularë pjesëmarrës në shorte do të ngarkohet në zgjidhjen software-ike të krijuar nga Vodafone që mundëson përzgjedhjen dhe renditjen në mënyrë rastësore të numrave celularë të cilët do të shpallen fitues. Sa më shumë bileta ka përfituar Pajtimtari, aq më e lartë është mundësia për të fituar.
- 3.9 Për çdo numër celulari të përzgjedhur, fitues do të konsiderohet personi i cili ka në përdorim numrin celular, që do të përcaktohet nga të dhënat që fituesi do të deklarojë kur të kontaktohet nëpërmjet telefonit gjatë shorteut, si dhe nga verifikimi që do të kryhet në momentin që do të paraqitet për tërheqjen e cmimit.
- 3.10 Shorteu dhe shpallja e numrave fitues do të zhvillohet në praninë e një përfaqësuesi të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit pranë Ministrisë së Financave dhe përfaqësuesve të Degës Rajonale të Njesisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, të cilët do të njoftohen nga Vodafone 20 (njëzet) ditë përpara, sipas kërkesave të VKM Nr.196/2017, si edhe në prani të Komisionit të Lojës së Fatit Promocionale të ngritur me këtë rast nga ana e Vodafone Albania Sh.A.
- 3.11 Shorteu dhe shpallja e numrave fitues do të bëhet pranë zyrave qendrore të Vodafone Albania me vendndodhje në: Autostrada Tiranë-Durrës, Rr. “Pavarësia”, Nr.61, Kashar, Tiranë, Shqipëri, në datë 24.12.2024, në orën 11.00. Cdo ndryshim i datës dhe orës do të komunikohen në zbatim dhe përputhje me pikën 3.10 më lart.
- 3.12 Numri i Pajtimtarëve Vodafone që parashikohet të marrin pjesë në këtë “Lojë Promocionale 2024”, mund të jetë rreth 500’000 (pesëqind mijë).



NENI 4 PJESËMARRJA

4.1 Pjesëmarrës në këtë Lojë Fati Promocionale kanë të drejtë të jenë:

- I. Të gjithë Pajtimtarët Vodafone, pa kufizim, të cilët kanë një numër celulari në përdorim dhe kanë të shkarkuar në telefon aplikacionin MyVodafone dhe/ose JUTH app. Pajtimtarët Vodafone do të kenë mundësi të përfitojnë bileta për të marrë pjesë në shorte cdo ditë për 24 ditë, nëse aksesojnë 1 herë në ditë aplikacionin My Vodafone App ose Juth App.
- II. Pajtimtarët mobile me parapagesë mund të kenë ose jo një paketë mujore aktive për të patur mundësi që të përfitojnë bileta për pjesëmarrje në lojë. Këto paketa ofrohen sipas cmimit të shitjes dhe janë si vijojnë:
 - **Vodafone Basic – 600 lekë me TVSH (500 lekë pa TVSH)**
 - **Vodafone Go – 1'100 lekë me TVSH (916.66 lekë pa TVSH)**
 - **Vodafone Run – 1'600 lekë me TVSH (1'333.33 lekë pa TVSH)**
 - **Vodafone Fly – 2'100 lekë me TVSH (1'750 lekë pa TVSH)**
- III. Për të gjithë Pajtimtarët mobile me kontratë NEXT, me paspagesë dhe Unlimited nuk kërkohet blerja e një paketë shtesë dhe/ose kyerja e një shpenzimi shtesë për pjesëmarrjen në Lojën Promocionale, por vetëm aksesimi i njërit prej aplikacioneve. Për nga vetë natyra e produkteve, këta Pajtimtarë, në bazë të kontratës, paguajnë vlerën e planit tarifor fiks mujor të zgjedhur dhe/ose vlerën e konsumit mujor. Planet tarifore të cilat i japin mundësinë e përfitimit të biletave të pjesëmarrjes në lojë Pajtimtarëve mobile NEXT, me paspagesë dhe Unlimited janë, por pa u kufizuar vetëm në:
 - **Vodafone Next Go – pajtim mujor 1000 lekë me TVSH (833.33 lekë pa TVSH)**
 - **Vodafone Next Run – pajtim mujor 1'500 lekë me TVSH (1'250 lekë pa TVSH)**
 - **Vodafone Next Fly– pajtim mujor 2'000 lekë me TVSH (1'666.66 lekë pa TVSH)**
 - **Vodafone Unlimited– pajtim mujor 2'300 lekë me TVSH (1'916.66 lekë pa TVSH)**
 - **Business Red – pajtim mujor 3'000 lekë me TVSH (2'500 lekë pa TVSH)**
 - **Business Red Pro – pajtim mujor 4'800 lekë me TVSH (4'000 lekë pa TVSH)**
 - **Business Red Prime – pajtim mujor 8'500 lekë me TVSH (7'083.33 lekë pa TVSH)**
 - **Business Black – pajtim mujor 12'500 lekë me TVSH (10'416.67 lekë pa TVSH)**
 - **Vodafone Unlimited – 2'200 lekë me TVSH (1'833.33 lekë pa TVSH)**
 - **Vodafone Unlimited+ - 2'500 lekë me TVSH (2,083.33 lekë pa TVSH)**
- IV. Kanë mundësi të përfitojnë bileta dhe të marrin pjesë në këtë Lojë Promocionale edhe të gjithë Pajtimtarët e tjerë që kanë një kontratë me paspagim dhe nuk kanë një nga planet tarifore me pagesë fikse mujore të sipërcituara dhe faturohen në bazë të konsumit mujor.
- V. Pajtimtarët Vodafone do të kenë mundësinë që gjatë gjithë periudhës 24 ditore të përfitojnë bileta për pjesëmarrje në shorte maksimalisht 1 (një) herë në ditë dhe vetëm nga aplikacioni që aksesohet i pari gjatë ditës. Numri i biletave që përfitojnë përlllogaritet në varësi të llojit të kontratës së pajtimtarit dhe konkretisht:



- **Pajtimtarët mobile me parapagesë përfitojnë 1 bilete cdo ditë që hyjnë në aplikacion;**
- **Pajtimtarët mobile NEXT dhe me Paspagesë përfitojnë 2 bileta cdo ditë që hyjnë në aplikacion;**
- **Pajtimtarët mobile Unlimited & Converged përfitojnë 3 bileta cdo ditë që hyjnë në aplikacion;**
- **Pajtimtarët fiks përfitojnë 2 bileta cdo ditë që hyjnë në aplikacion;**

4.2 Të gjithë pjesëmarrësit kanë mundësinë të kontrollojnë në cdo kohë numrin e biletave të përfituara nëpërmjet aplikacionit MyVodafone dhe/ose JUTH app.

4.3 Nga dita e fundit, të gjithë pjesëmarrësit në “Lojën Promocionale 2024”, që kanë në përdorim një numër të telefonisë së lëvizshme (mobile) Vodafone, do të përfitojnë dhuratë Internet pa limit deri në fund të vitit.

4.4 Pjesëmarrësit në Lojën Promocionale duhet të jenë mbi 18 vjeç. Nëse numri i përzgjedhur është në përdorim të një të mituri (nën 18 vjeç) atëherë çmimi do të tërhiqet prej prindit/kujdestarit ligjor. Vodafone nuk do të promovojë pjesëmarrjen e personave të mitur.

4.5 Nuk mund të marrin pjesë në këtë Lojë Fati Promocionale:

- i. Punonjësit e Vodafone Albania Sh.A.
- ii. Përdoruesit e planeve tarifore me parapagesë dhe/ose kontratë Vodafone Mobile Broadband.
- iii. Përdoruesit e produkteve dhe shërbimeve IoT, M2M, telemetric SIM.

4.6 Në rastin e Pajtimtarëve mobile që janë shoqëri ose institucione publike/private, përdoruesit që përdorin numrat e këtyre pajtimtarëve do të përjashtohen nga Loja e Fatit Promocionale, nëse ka një kërkesë paraprake të depozituar në Vodafone nga ana e këtyre pajtimtarëve për mos lejimin e pjesëmarrjes në Lojën Promocionale.

Neni 5 TERRITORI

5.1 Loja promocionale “Promo e Fundvitit 2024” do të zhvillohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 6 ÇMIMET

6.1 Pas gjenerimit të listës së fituesve nga platforma e përdorur për hedhjen e Shorteut (në datë 24.12.2024) do të shpallen në total 51 fitues të cilët do të kenë mundësinë të përfitojnë një nga cmimet si më poshtë vijon:

- *Autoveturë “Mercedes Benz” – vlera monetare 6.000.000 (gjashtë milion) lekë me Tvsh.*



- *Iphone 16 Pro Max – vlera monetare 137,570 (njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë me Tvsh, si edhe dhuratë 10GB internet, cdo muaj për një periudhë 1 vjecare (vlerë monetare 10 GB = 1000 (njëmijë) lekë/muaj me TVSH.*
- *TV Samsung (55 inch) – vlera monetare 53,000 (pesëdhjetë e tre mijë) lekë me Tvsh, së bashku me shërbimin VTV PREMIUM për 1 vit falas. (vlera monetare e VTV Premium në muaj: 700 (shtatëqind) lekë me TVSh.*

6.2 Fituesit e secilit cmim do të përcaktohen në bazë të renditjes rastësore që do të gjenerojë zgjidhja software-ike që do të përdoret për hedhjen e shorteut, sipas renditjes së përcaktuar në paragrafin 6.3.

6.3 Cmimet do të shpërndahen sic paraqitet në mënyrë të detajuar më poshtë:

Renditja e fituesit	Cmimi	Sasia totale	Vlera totale monetare (me tvsh)
Nga 1 – 25	TV Samsung (55 inch) + VTV Premium për 12 muaj	25	1,535,000 Lekë (1,325,000 Lekë TV Samsung +210,000 Lekë VTV Premium)
Nga 26 deri në 50	Iphone 16 Pro Max + 10GB Internet për 12 muaj	25	3,739,250 Lekë (3,439,250 lekë Iphone 16Pro Max+ 300,000 lekë 10GB Internet)
I/E renditura e 51	Autoveture ‘Mercedes Benz’	1	6,000,000 Lekë
Total			11,274,250 Lekë

6.4 Në total, Vodafone do të ofrojë 51 çmime. Vlera totale monetare e çmimeve që do të shpërndahen sipas tabelës më sipër do të jetë **11,274,250** (njëmbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë) Lekë me Tvsh.

6.5 Cmimet e Lojës së Fatit Promocionale janë të patransferueshme pavarësisht çdo rrethane apo situatë.

6.6 Vodafone mund të refuzojë dhënien e çmimit/çmimeve në rast se konstaton se nuk janë respektuar kushtet e kësaj Rregulloreje, apo në rast se fituesit rezultojnë të tillë si rezultat i ndonjë parregullsie apo mashtrimi.

Neni 7

NJOFTIMI I FITUESVE DHE TËRHEQJA E CMIMIT

7.1 Numrat fitues do të telefonohen ditën e shorteut (24.12.2024) në praninë e përfaqësuesve ligjorë të Autoritetit të Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit, të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj të një Noteri Publik dhe të të ftuarve të tjerë të Vodafone Albania dhe punonjësve të saj, në zbatim të pikës 3.10 më lart. Nëse nuk përgjigjet pas 2 tentativave, do të telefonohet numri vijues në rradhë, i cili automatikisht do të përfitojë atë cmim sipas renditjes së çmimeve të përcaktuar në pikën 6.3 më lart. Palët do të nënshkruajnë një Procesverbal mbi Shorteun e hedhur.



- 7.2 Pas gjenerimit të listës së fituesve nga platforma e përdorur për hedhjen e shorteut, numrat fitues do të lajmërohen gjithashtu me anë të një mesazhi (SMS) ku do të informohen që janë fitues të Lojës Promocionale “Promo e Fundvitit 2024”. Fituesit do të kontaktohen edhe me telefon nga agjentët e Contact Center të Vodafone ku do të kërkohen edhe detajet identifikuese të përdoruesit të numrit për identifikimin e qartë dhe transparent të fituesit, përfshirë të dhënat personale sipas pikës 7.3 në vijim.
- 7.3 Në momentin e paraqitjes për tërheqjen e çmimit, fituesve do t’ju kërkohet të japin përsëri dhe të konfirmojnë të dhënat e tyre të cilat janë: Emër, Atësi, Mbiemër, Datëlindje, kopje e kartës së identitetit dhe/ose e pasaportës si dhe adresa e banimit. Fituesi duhet të jetë i pajisur edhe me numrin e telefonit aktiv me të cilin është shpallur fitues dhe të paraqesë mesazhin (SMS) sipas pikës 7.2 më lart. Fituesi do të nënshkruajë një procesverbal pranimi të dhuratës së fituar dhe/ose kontratë sipas legjislacionit në fuqi.
- 7.4 Nëse fituesi nuk paraqitet në eventin e ndarjes së çmimeve për të tërhequr dhuratën do të ketë mundësi ta tërheqë në dyqanin më të afërt pranë zonës së banimit. Kjo është e vlefshme vetëm për cmimet: Iphone 16 Pro Max & TV Samsung.

Neni 8 TË DHËNAT E PJESËMARRËSVE

8.1 Cdo pjesëmarrës në këtë Lojë Fati Promocionale pranon shprehimisht se Vodafone mund të përpunojë të dhënat e tyre personale, të kërkuara sipas Neni 7.2 të kësaj Rregulloreje, për qëllime të kësaj Lojë Fati Promocionale dhe për çdo qëllim tjetër të ligjshëm të Vodafone në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9887/2008, “Per Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Të gjitha të dhënat personale lidhur me fituesit dhe të dhënat për mënyrën e organizimit të Lojës së Fatit Promocionale do të ruhen për një periudhë jo më pak se 6 vjet sipas kërkesave të VKM nr. 196/2017.

Neni 9 TAKSA DHE TATIMET

Fituesi nuk do të jetë subjekt detyrimesh, tarifash apo garancish që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çmimin, përveç atyre të cilat mund të kërkohen detyrimisht për fituesin nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 10 PUBLICITETI

- 10.1 Komunikimi i Lojës Promocionale do të bëhet nëpërmjet një spoti televiziv, reklamimit në radio, reklamimit në gazeta, reklamimit me banera në qytet dhe reklamime në faqe interneti. Gjithashtu për këtë qëllim do të ketë deklarata për shtyp dhe artikuj të ngjashëm.
- 10.2 Me pranimin e çmimit, fituesit kanë dhënë miratimin që emri dhe imazhi i tyre të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Vodafone Albania www.vodafone.al dhe në faqet zyrtare që Vodafone ka në rrjetet sociale si: Facebook, Instagram, LinkedIn. Gjithashtu, fituesit i japin Vodafone të drejta të plota lidhur me përdorimin e të drejtave të imazhit të tyre në fotografitë, videot (ose cdo version të tyre që ka prezencën e tyre) të cilat do të shfaqen në publik në kuadrin e fushatave promovionale aktuale apo të ardhshme të Vodafone Albania Sh.A.



Neni 11 FORCA MADHORE

11.1 Loja Promocionale mund të ndërpritet vetëm në rastin e rrethanave për të cilat Vodafone nuk është përgjegjëse, dmth: që nuk mund parandalohen, riparohen apo shmangen dhe në rast të ndonjë urdhërimi sipas ligjeve në fuqi nga autoritetet shtetërore. Njoftimi për ndërprerjen edhe cdo njoftim tjetër i rëndësishëm në lidhje me Lojën e Fatit Promocionale, do të publikohet në <http://www.vodafone.al>.

Neni 12 ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

12.1 Me pjesëmarrjen në këtë Lojë Promocionale pajtimtarët Vodafone kanë dhënë miratimin e tyre duke pranuar automatikisht rregullat dhe mekanizmin e Lojës Promocionale. Në rast të kërkesave të pajtimtarëve për të mos u përfshirë në këtë Lojë Promocionale, Vodafone Albania Sh.A nuk do t'i përfshijë ata në shorteun që do të hidhet për shpalljen e fituesve. Në rast mosmarreveshjesh, organi kompetent për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 13 TE NDRYSHME

13.1 Rregullorja e Lojes Promocionale do të publikohet edhe në faqen në internet të Vodafone, <http://www.vodafone.al>. Informacioni mbi Lojën Promocionale mund të merret gjithashtu prej Shërbimit për Kujdesin e Klientit duke telefonuar falas në numrin 140.

Tiranë, më **18.10.2024**